

L I G J
PËR INSPEKTORATIN SHTETEROR TË VETADMINISTRIMIT LOKAL

I. DISPOZITA TË PERGJITHSHME

Lenda e rregullimit

Neni 1

Me kete ligj rregullohen kompetenca dhe organizimi i Inspektoratit Shtetere të Vetadministrimit Lokal, llojet dhe procedura e kryerjes së mbikeqyrjes inspektuese, autorizimet e inspektoreve, bashkepunimi me organet e administrates shtetere, qytetaret dhe personat tjere fizike dhe juridike.

Qellimi i Ligjit

Neni 2

Qellimi i ketij ligji eshte të sigurohet sistem më efektiv, më efikas dhe sistem juridikisht i rregulluar për mbikeqyrje të ligjshmerise dhe rregullave të komunave, qytetit të Shkupit dhe komunave në qytetin e Shkupit (në tekstin e metejshem: komuna) dhe për perparimin e ligjshmerise së tyre.

Kuptimi i shprehjeve të perdorura në kete ligj

Neni 3

Shprehjet e caktuara të perdorura në kete ligj e kane kete kuptim:

1. "Rregulla të komunes" jane statuti i komunes, programi, planet, vendimet, aktvendimet, konkluzionet dhe akte tjera të pergjithshme që i miraton Keshilli i Komunes dhe aktet me të cilat nderlidhet bashkepunimi nderkomunal, si dhe aktet konkrete që i miraton kryetari i komunes për zbatimin e akteve të Keshillit Komunal;
2. "Mbikeqyrje" eshte mbikeqyrja e ligjshmerine së rregullave të komunave që e kryen Inspektorati sipas Ligjit për vetadministrim lokal dhe me iniciativa të personave fizike dhe juridike;
3. "Mbikeqyrje inspektuese" eshte mbikeqyrja e procedures për miratimin e rregullave të komunave, që Inspektorati e kryen jashte selise së tij;
4. "Mbikeqyrje e rregullt inspektuese" eshte mbikeqyrja inspektuese që kryhet në pajtim me programin vjetor për pune dhe planet mujore të Inspektoratit.
5. "Mbikeqyrje e jashtezakonshme inspektuese" eshte mbikeqyrja e paparalajmeruar inspektuese që kryhet në baze të kerkesave, njoftimeve, sugjerimeve dhe ankesave nga ana e personave fizike dhe juridike, si dhe në raste të dyshimit të bazuar të Inspektoratit dhe
6. "Mbikeqyrje kontrolluese inspektuese" eshte mbikeqyrja inspektuese që Inspektorati e kryen pas kalimit të afatit të percaktuar në procesverbal për mbikeqyrjen e kryer inspektuese, me të cilen Keshilli Komunal, kryetari i komunes ose personi i autorizuar, jane të obliguar që t'i evitojne parregullsite e konstatuara të percaktuara me mbikeqyrjen inspektuese.

Kompetenca

Neni 4

Mbikeqyrjen inspektuese nga neni 3 i këtij ligji, e kryen Inspektorati Shteteror i Vetadministrimit Lokal (në tekstin e metejshem: Inspektorati), si organ në perberje të Ministrise së Vetadministrimit Lokal.

Lenda e mbikeqyrjes

Neni 5

- (1) Lende e mbikeqyrjes eshte mbikeqyrja e ligjshmerise së rregullave të komunave.
- (2) Mbikeqyrja për ligjshmerine e rregullave të komunave e perfshin edhe mbikeqyrjen mbi proceduren për miratimin e tyre.

II. PARIME

Parimi për ligjshmeri dhe subsidiaritet

Neni 6

(1) Në kryerjen e detyrave brenda kompetencave të tij, Inspektorati ofron siguri ligjore dhe siguri me:

- respektimin e obligimit që të gjitha rregullat që miratohen nga ana e Keshillit të Komunave të jene në harmonizim me Kushtetuten dhe ligjet dhe
- veprim dhe vendimmarrje në perputhje me ligjin, marreveshjet nderkombetare të ratifikuara në pajtim me Kushtetuten e Republikes së Maqedonise dhe rregulla tjera të miratuara në baze ligjit.

(2) Për ceshtje që nuk rregullohen me kete ligj, zbatohen dispozitat e Ligjit për vetadministrim lokal dhe të Ligjit për mbikeqyrje inspektuese.

Parimi i transparences, publicitetit dhe raportimit

Neni 7

(1) Me kerkese të personave juridike dhe fizike, Inspektorati eshte i obliguar që të siguroje qasje te informatat lidhur me punen e Inspektoratit, si dhe informata tjera për të cilat ata do të tregojne interesim, pervec atyre për të cilat qasja nuk lejohen me ligj.

(2) Inspektorati rregullisht e informon publikun për punen e vet.

Parimi i barazise, paanshmerise dhe objektivitetit

Neni 8

Në kryerjen e detyrave nga kompetenca e vet, Inspektorati eshte i obliguar që të siguroje zbatim të barabarte, të paanshem dhe objektiv të ligjeve dhe rregullave tjera.

Parimi i mevetesise dhe pavaresise

Neni 9

Inspektori plotesisht mevetesishem dhe në menyre të pavarur kryen mbikeqyrje inspektuese mbi ligjshmerine e rregullave dhe procedures së miratimit të tyre dhe në baze të fakteve relevante

juridike të percaktuara në procedurën argumentuese, pergatit akte me të cilat propozon zgjidhje konkrete.

Parimi i parandalimit

Neni 10

Për parandalimin e paraqitjes së demit material dhe pasigurise juridike si pasoje e zbatimit të rregullave të komunes që nuk janë në pajtim me Kushtetuten dhe ligjet e Republikës së Maqedonise, Inspektori ndermerr masa dhe aktivitete në pajtim me rregulloren për punë inspektuese.

III. ORGANIZIMI I INSPEKTORATIT

Organizimi i brendshem

Neni 11

- (1) Inspektorati punët e kompetences së vet i kryen nepermjet:
 - Drejtorit të Inspektoratit (në tekstin e metutjeshem: drejtori) dhe
 - Inspektoreve të vetadministrimit lokal (në tekstin e metutjeshem: inspektoret).
- (2) Organizimin e brendshem të Inspektoratit, me propozim të drejtorit në pajtim me ligjin, drejtperdrejt e percakton ministri i Vetadministrimit Lokal, me aktet për organizimin e brendshem të Inspektoratit.

Drejtori

Neni 12

- (1) Me punën e Inspektoratit udheheq drejtori, të cilin e emeron dhe e shkarkon Qeveria e Republikës së Maqedonise. (2) Drejtori ndermerr masa dhe kujdeset për aftesimin dhe ngritjen profesionale të inspektoreve.
- (3) Për drejtor të Inspektoratit mund të emerohet personi i cili ka arsim të lartë nga sfera e drejtesise, ekonomise dhe administrates dhe së paku pese vite pervoje pune në profesionin.

Inspektoret

Neni 13

- (1) Inspektor mund të jete personi i cili ka arsim të lartë, tre vite pervoje pune në profesion dhe i ploteson kushtet e pergjithshme të percaktuara me Ligjin për nepunes shteterore dhe kushtet e vecanta të percaktuara me aktin e sistematizimit të vendeve të punes në Inspektorat.
- (2) Statusi i inspektorit, percaktohet në pajtim me dispozitat e Ligjit për mbikeqyrje inspektuese.

Legjitimacioni zyrtar

Neni 14

(1) Autorizimin për kryerjen e mbikeqyrjes inspektuese, inspektori e deshmon me legjitimacion zyrtar, me të cilin i deshmon cilesine, identitetin dhe autorizimet e tij.

(2) Formen dhe permbajtjen e formularit të legjitimacionit zyrtar, pamjen e shenjes, si dhe menyren e dhenies dhe heqjes së legjitimacionit zyrtar, i percakton ministri i Vetadministrimit Lokal me propozim të drejtorit.

Programi i punes

Neni 15

Për kryerjen e mbikeqyrjes së rregullt inspektuese, drejtori miraton program të punes, pergatit plane mujore të punes së Inspektoratit dhe e organizon realizimin e tyre.

Raporti i punes

Neni 16

(1) Drejtori pergatit raport gjashtemujor dhe vjetor për punen e Inspektoratit për vitin paraprak dhe e dorezon në Qeverine e Republikes së Maqedonise, më së voni deri më 31 mars në vitin rrjedhes.

(2) Raporti nga paragrafi (1) i ketij ligji, në vecanti i permban:

- vleresimin e gjendjeve nga aspekti i ligjshmerise së rregullave të keshillave komunale,
- të dhenat për numrin e mbikeqyrjeve të kryera në komuna dhe shkeljet e percaktuara,
- të dhenat për aktvendime të miratuara për nderprerjen e zbatimit të rregullave të keshillave komunale dhe për mosrespektimin e obligimeve të kryetareve të komunave për zbatimin dhe aplikimin e dispozitave të Ligjit për vetadministrim lokal dhe të ketij ligji,

- të dhenat për numrin e iniciativave të parashtruara para Gjykates Kushtetuese të Republikes së Maqedonise për vleresimin e kushtetutshmerise dhe ligjshmerise së rregullave të komunes dhe për aktvendimet, respektivisht vendimet e Gjykates Kushtetuese për iniciativat e parashtruara,

- rekomandimet për permiresimin e gjendjeve të percaktuara dhe

- të dhena tjera me rendesi për punen e Inspektoratit. (3) Raporti vjetor publikohet në ueb-faqen e Ministrise së Vetadministrimit Lokal.

IV. LLOJET DHE PROCEDURA E KRYERJES SË MBIKEQYRJES INSPEKTUESE

Llojet e mbikeqyrjes inspektuese

Neni 17

Mbikeqyrja inspektuese mund të jete:

- 1) Mbikeqyrje e rregullt inspektuese;
- 2) Mbikeqyrje e jashtezakonshme inspektuese dhe
- 3) Mbikeqyrje kontrolluese inspektuese.

Kryerja e mbikeqyrjes inspektuese

Neni 18

(1) Inspektori në menyre të pavarur i kryen punet e mbikeqyrjes inspektuese dhe ndermerr masa për të cilat është i autorizuar me kete ligj.

(2) Mbikeqyrja inspektuese kryhet në orarin e punes. (3) Për ditën, permbajtjen dhe vellimin e mbikeqyrjes inspektuese, inspektori e njofton kryetarin e komunes dhe kryetarin e keshillit komunal në të cilen do të kryhet mbikeqyrja, më së voni shtate dite para dites që është percaktuar për kryerjen e mbikeqyrjes. Obligimi i legjitimit

Neni 19

Inspektori është i obliguar që gjate kryerjes së mbikeqyrjes inspektuese ta tregojë legjitimacionin zyrtar.

Sigurimi i kushteve për kryerjen e mbikeqyrjes inspektuese dhe qasja në dokumentacion

Neni 20

(1) Kryetari i Komunes, kryetari i keshillit komunal ose personi i autorizuar, në rast të mbikeqyrjes inspektuese mbi ligjshmerine e rregullave të komunes, jane të obliguar që inspektorit t'i mundesojne kryerje pa pengese të mbikeqyrjes dhe t'ia sigurojne dhe krijojne kushtet e nevojshme për kryerjen e mbikeqyrjes dhe t'ia japin në shikim dhe disponim rregullat e nevojshme, procesverbalet nga seancat e Keshillit të Komunes, evidencen për prezence në seanca të anetareve të Keshillit ose dokumente tjera që ai do t'i kerkojne.

(2) Kryetari i komunes është i obliguar që t'i paraqese për shikim edhe iniciativat e parashtruara për ngritjen e procedures për vleresim të kushtetutshmerise dhe ligjshmerise së rregullave të komunes dhe vendimet e Gjykates Kushtetuese të Republikës së Maqedonise, të miratuara me rastin e iniciativave të kryetarit të komunes.

(3) Gjate kryerjes së mbikeqyrjes inspektuese, inspektori ka të drejte që të kerkoje kopje nga rregullat dhe aktet e ngjashme me origjinalin, të vertetuara nga personi i autorizuar i komunes.

(4) Nese komuna në të cilen duhet të kryhet mbikeqyrja inspektuese për arsye objektive nuk mund të siguroje dhe krijojne kushte të nevojshme për kryerjen e saj në terminin e caktuar, kryetari i komunes mund të kerkoje prolongimin e mbikeqyrjes inspektuese jo më gjate se shtate dite.

(5) Nese gjate kryerjes së mbikeqyrjes inspektuese kryetari i komunes, kryetari i keshillit komunal ose personi i autorizuar, nuk kane mundesi t'i japin në shikim dhe disponim rregullat e kerkuara, procesverbalet e seancave të Keshillit Komunal, evidencen për pjesemarrje në seanca të anetareve të Keshillit komunal ose dokumente tjera, inspektori mund t'i obligoje që t'i dorezojne në afat të caktuar në Inspektorat.

(6) Nese kryetari i komunes, kryetari i keshillit komunal ose personi i autorizuar nuk sigurojne kushte për kryerjen e mbikeqyrjes inspektuese edhe pas perfundimit të afatit nga paragrafi (4) i ketij neni, ose nuk i dorezojne rregullat e kerkuara, procesverbalet e seancave të Keshillit Komunal, evidencen për pjesemarrjen e anetareve të Keshillit ose dokumentet tjera në afatin e percaktuar nga inspektori, perfundon të rrjedhe afati për marrjen e aktvendimit për ndalimin e zbatimit të rregulles së percaktuar në Ligjin për vetadministrim lokal dhe ai vazhdon të rrjedhe nga dita e mbikeqyrjes së kryer, respektivisht nga dita e dorezimit të rregullave dhe procesverbaleve të kerkuara.

(7) Nese gjate kryerjes së mbikeqyrjes inspektuese, inspektori i autorizuar percakton se është kryer parregullsi nga

paragrafi (6) i ketij neni, eshte i obliguar qe parregullsine e percaktuar ta shenoje ne procesverbalin e pergatitur sipas

nenit 21 te ketij ligji dhe njekohesisht t'i dorezoje ftese per edukim, personit pergjegjes ne komune.

(8) Formen dhe permbajtjen e fteses per edukim, si dhe menyren e realizimit te edukimit e percakton ministri i Vetadministrimit Lokal.

(9) Nese ne terminin e caktuar nga paragrafi (7) i ketij neni, nuk paraqitet ne edukim, respektivisht perserite ndonje nga parregullsine e percaktuara ne paragrafin (7) te ketij neni, drejtori i Inspektoratit para gjykates kompetente ose Komisionit per Kundervajtje, parashtron kerkese per ngritjen e procedures kundervajtes kunder personit pergjegjes ne komunen e kontrolluar.

Procesverbali

Neni 21

(1) Per mbikeqyrjen e kryer inspektuese, inspektori perpilon procesverbal ne dy ekzemplare.

(2) Procesverbalin e nenshkruajne personat qe kane marre pjese ne proceduren e mbikeqyrjes.

(3) Kur personi i cili ka marre pjese ne proceduren e mbikeqyrjes refuzon ta nenshkruaje procesverbalin, inspektori kete do ta shenoje dhe do t'i theksoje arsyet e refuzimit.

(4) Nje ekzemplar nga procesverbali dorezohet ne komune, menjehere pas mbikeqyrjes se kryer.

Kundershtimi

Neni 22

(1) Kryetari i komunes dhe kryetari i Keshillit Komunal ose personi pergjegjes, kane te drejte kundershtimi ndaj procesverbalit nga neni 21 paragrafi (1) te ketij ligji, ne afat prej tete ditesh nga dita e pranimit te tij.

(2) Kundershtimi nga paragrafi (1) i ketij neni, parashtrohet ne Inspektorat.

(3) Inspektorati eshte i obliguar qe te pergjigjet ndaj kundershtimit pa prolongim, e me se voni tete dite nga pranimi i kundershtimit, me ate qe mund t'i pranoje verejtjet dhe te njejtat te behen pjese perberese te procesverbalit, ose t'i hedh poshte si te pabaza.

Nderprerja e zbatimit te rregulles

Neni 23

(1) Per rregull per te cilen inspektori konsideron se ekzistojne kushte per ndalimin e zbatimit te saj per shkak te mosharmonizimit me Kushtetuten ose ligjin, pergatit aktvendim per ndalimin e zbatimit te rregulles.

(2) Per rregullen per te cilen eshte miratuar aktvendimi per ndalimin e zbatimit te saj per shkak te mosharmonizimit me Kushtetuten ose ligjin, inspektori pergatit initiative per ngritjen e procedures per vleresimin e kushtetutshmerise ose ligjshmerise se rregulles ne Gjykatën Kushtetuese.

(3) Aktet nga paragrafet (1) dhe (2) te ketij neni, i miraton drejtori i Inspektoratit dhe te njejtat ne afat prej tri ditesh i publikon ne ueb faqen e Ministrise se Vetadministrimit Lokal.

(4) Per miratimin e aktvendimit nga paragrafi (1) i ketij neni, publikimin e tij dhe parashtrimin e initiatives nga paragrafi (2) i ketij neni, zbatohen dispozitat e Ligjit per vetadministrim lokal.

(5) Kunder aktvendimit nga paragrafi (3) i ketij neni, lejohet ankese në Ministrine e Vetadministrimit Lokal, në afat prej tri ditesh nga pranimi i aktvendimit. Ankesa nuk e prolongon zbatimin e aktvendimit. Propozim për ngritjen e procedures

Neni 24

(1) Nese inspektori gjate kryerjes së mbikeqyrjes inspektuese verën se ka dyshim të bazuar për ekzistimin e kundervajtjes ose vepres penale, respektivisht se ekziston baze për ndermarrjen e masave administruese ose masave tjera për ndermarrjen e të cilave eshte kompetent organi tjetër, eshte i obliguar që të parashtroje kallezim për ngritjen e procedures kundervajtese ose penale, respektivisht pa prolongim ta njoftoje organin kompetent për ndermarrjen e masave administrative ose masave tjera.

(2) Nese inspektori nuk vepron në pajtim me paragrafin (1) të ketij neni, konsiderohet se ka kryer shkelje disiplinore.

Konflikti i interesave

Neni 25

(1) Inspektori nuk guxon që të kryeje ose të marre pjese në mbikeqyrje inspektuese, nese anetari i familjes së tij eshte kryetar komune ose kryetar i Keshillit të Komunes ku kryhet mbikeqyrja.

(2) Si anetar i familjes nga paragrafi (1) i ketij neni, konsiderohet personi i cili eshte në lidhje gjaku në vije të drejte me inspektorin i cili kryen ose merr pjese në mbikeqyrje.

V. BASHKEPUNIMI DHE EVIDENCA

Avancimi i ligjshmerise

Neni 26

Inspektorati bashkepunon me organet e administrates shteterore, personat e interesuar fizike dhe juridike dhe asociacionet e tyre, në sigurimin dhe avancimin e ligjshmerise së rregullave të komunes.

Iniciativa

Neni 27

(1) Organet e administrates shteterore, shoqatat e qytetareve dhe personat tjere juridike dhe fizike mund të parashtrojne iniciativa në forme të njoftimeve, propozimeve dhe parashtrësive në Inspektorat, për kryerjen e mbikeqyrjes inspektuese.

(2) Për masat e ndermarra ndaj iniciatives së parashtruar, Inspektorati do t'i njoftoje subjektet nga paragrafi (1) i ketij neni, në afat prej 30 ditesh nga dita e parashtrimit të iniciatives.

Evidentimi

Neni 28

(1) Inspektorati mban evidence për vendimet dhe aktvendimet e miratuara të Gjykates Kushtetuese të Republikës

së Maqedonise për vleresimin e kushtetutshmerise dhe ligjshmerise së rregullave të komunave, pas iniciativave të parashtruara nga Inspektorati dhe mundeson qasje të saj te publiku, nepermjet ueb-faqes së Ministrise së Vetadministrimit Lokal.

(2) Vendimet dhe aktvendimet e Gjykates Kushtetuese, detyrimisht shpallen në Fleten zyrtare të komunes për të cilen kane të bejne

VI. DISPOZITA KUNDERVAJTESE

Neni 29

Gjobe në vlere prej 1 000 deri në 1 500 euro në kundervlere me denare, do t'i shqiptohet për kundervajtje personit pergjegjes në komune, nese edhe pas kalimit të afatit nga neni 20 paragrafi (6) të ketij ligji, nuk siguron kushte për kryerjen e mbikeqytjes inspektuese, ose nuk i dorezon rregullat dhe procesverbalet e kerkuara në afatin e percaktuar nga inspektori.

VII. DISPOZITA KALIMTARE DHE PERFUNDIMTARE

Neni 30

Aktet nenligjore të parapara me kete ligj do të miratohen në afat prej 30 ditesh nga dita e hyrjes në fuqi të ketij ligji.

Neni 31

Procedurat e filluara para dites së hyrjes në fuqi të ketij ligji, do të kryhen në pajtim me dispozitat e Ligjit për vetadministrim lokal.

Neni 32

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tete nga dita e botimit në "Gazeten Zyrtare e Republikës së Maqedonise".